

20150882775

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN LIGJIT PËR MUZE

Neni 1

Në Ligjin për muze ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/2004, 89/2008, 116/10 dhe 51/11) në nenin 3 paragrafi (2) fjala "grumbullim" zëvendësohet me fjalën "marrje".

Neni 2

Në nenin 15 paragrafi (1) në pikën 1) fjala "grumbullojnë" zëvendësohen me fjalën "marrin".

Neni 3

Në nenin 16 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Për muze amë sipas llojit të objekteve të muzeut caktohen Institucioni Nacional "Muzeu i Maqedonisë" - Shkup, Institucioni Nacional "Muzeu i Artit Modern" – Shkup, Institucioni Nacional "Muzeu Arkeologjik i Maqedonisë" – Shkup dhe Institucioni Nacional "Muzeu Shkencor Natyror i Maqedonisë" – Shkup.

Neni 4

Në nenin 18 para fjalës "Muzetë" shtohet numri "(1)".

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Për materialin e muzeut dhe objektet e muzeut të cilat merren nëpërmjet blerjes, dhuratave, legatëve, trashëgimive, këmbimit, dhënies dhe marrjes, muzeu duhet të bëjë kontroll paraprak të prejardhjes së materialit të muzeut dhe objekteve të muzeut në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni, muzeu duhet të sigurojë edhe dëshmi për pronësinë e objektit (marrëveshja e shitblerjes, akti i trashëgimisë ose deklaratë për pronësi të sendit), si dhe deklaratë të verifikuar në noter se objekti nuk rrjedh prej gërmimeve të palejuara dhe të pakontrolluara, vjedhjeve, eksportit dhe importit të palejuar ose nga veprat tjera kundërligjore."

Neni 5

Titulli i nenit 19 dhe neni 19 ndryshohen si vijojnë:

"Mbrojtja e materialit të muzeut dhe objekteve të muzeut

Neni 19

(1) Muzetë janë të obliguar të zbatojnë mbrojtje preventive dhe permanente të materialit të muzeut dhe sendeve të muzeut.

(2) Mbrojtja preventive përfshin:

- sigurim të kushteve optimale mikroklimaterike dhe të ndriçimit për prezantim dhe ruajtje të materialit të muzeut dhe sendeve të muzeut ;
- mbrojtje nga ndikimi i materieve të dëmshme dhe procedura tjera preventive;
- qasjen e të punësuarve te materiali i muzeut dhe sendet e muzeut;
- qasjen e vizitorëve te materiali i muzeut dhe sendet e muzeut;
- garantim masash sigurie për ruajtje të materialit të muzeut dhe sendeve të muzeut në hapësirat e ekspozitave dhe në depon e muzeut;
- garantim masash sigurie gjatë manipulimit me materialin dhe sendet e muzeut të vendosura në depon e muzeut;
- garantim masash sigurie dhe gjatë transportit të materialit dhe sendeve të muzeut.

(3) Mbrojtja permanente e materialit dhe objekteve të muzeut zbatohet me aplikimin e masave konzervatoriale në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

(4) Mënyrën e zbatimit të mbrojtjes preventive të materialit të muzeut dhe sendeve të muzeut e përcakton ministri, me propozim të Drejtorisë për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.”

Neni 6

Në nenin 20 paragrafi (5) fjalët: "një vit" zëvendësohen me fjalët: "dy vite".

Neni 7

Në nenin 21 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“Revidimi i objekteve të muzeut bëhet si revidim i rregullt dhe i jashtëzakonshëm.”

Pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

“(4) Revidim i rregullt i objekteve të muzeut bëhet në çdo pesë vite.

(5) Revidim i jashtëzakonshëm bëhet kur:

- objektet e muzeut zhvendosen prej një muzeu në tjetër muze dhe
- personi i cili është përgjegjës për përmbledhjen e muzeut do të sistematizohet në vend tjetër të punës, ose kur do t’i pushojë marrëdhënia e punës.”

Paragrafi (4) që bëhet paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

“(6) Mënyra se si bëhet revidimi i objekteve të muzeut përcaktohet nga ministri.”

Neni 8

Pas nenit 22 shtohet titull i ri dhe nen i ri 22-a si vijon:

“Ekzemplari i detyrueshëm i bankënotave dhe monedhave

Neni 22-a

(1) Për shkak të mbrojtjes, ruajtjes dhe shfrytëzimit të bankënotave dhe monedhave si ekzemplar të detyrueshëm, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë i dorëzon tre ekzemplarë identikë të secilës bankënotë dhe monedhë në Institucionin Nacional -"Muzeu i Maqedonisë" - Shkup dhe Institucionin Nacional "Muzeu Arkeologjik i Maqedonisë", para lëshimit të saj në qarkullim.

(2) Ekzemplari i detyrueshëm mbrohet, ruhet dhe shfrytëzohet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.”

Neni 9

Pas nenit 29 shtohen titull i ri dhe nen i ri 29-a, si vijojnë:

“Vlerësim profesional i objekteve artistike dhe të tjera

Neni 29-a

(1) Vlerësim profesional i origjinalitetit të objekteve artistike të autorëve nga Republika e Maqedonisë, si dhe të objekteve dhe ikonave arkeologjike, etnologjike, historike dhe teknike (në tekstin e mëtejme: objektet artistike dhe të tjera), sipas lëndës së punës kryejnë:

- Institucioni Nacional “Muzeu i Artit Modern” – Shkup ose Institucioni Nacional “Galeria Nazionale e Maqedonisë” – Shkup, për objektet artistike;

- Institucioni Nacional “Muzeu i Maqedonisë” – Shkup, për objektet dhe ikonat etnologjike, historike dhe teknike dhe

- Institucioni Nacional “Muzeu Arkeologjik i Maqedonisë” – Shkup, për objekte arkeologjike.

(2) Për kryerje të vlerësimit profesional të origjinalitetit të objekteve artistike dhe të tjera, drejtori i institucionit nacional nga paragrafi (1) i këtij neni me aktvendim themelon komision për vlerësim profesional të origjinalitetit të objekteve artistike dhe tjera, që është i formuar prej kryetarit dhe katër anëtarëve, ndër të cilët përgjegjësi këshilltar, këshilltari konzervator ose person profesional me së paku 20 vite përvojë pune nga fusha ose titull shkencor konkret për objektet artistike përkatësisht të tjera të cilat janë lëndë e vlerësimit profesional. Pëlqim të aktvendimit për themelim të komisionit për vlerësim profesional të origjinalitetit të objekteve artistike dhe të tjera jep ministri i Kulturës.

(3) Institucioni nacional nga paragrafi (1) i këtij neni jep mendim për vlerësim profesional të origjinalitetit të objekteve artistike dhe tjera në afat prej 30 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(4) Mendimi për vlerësimin profesional të origjinalitetit të veprave artistike dhe tjera përmban të dhëna për veprën, stilin, metodën dhe teknikën e përpunimit të veprës, gjendjen në të cilën gjendet vepra, testin e kryer shkencor/laboratorik dhe tjetër dhe elemente në bazë të të cilave përcaktohet origjinaliteti i objekteve artistike dhe të tjera.

(5) Nëse institucioni nacional i paragrafit (1) të këtij neni konsiderohet si jokompetent për dhënie të mendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, e udhëzon kërkuesin në institucionin kompetent për dhënie të mendimit.

(6) Për dhënien e mendimit nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtrohet kërkesë në institucionin nacional nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Për dhënie të mendimit nga paragrafi (4) i këtij neni paguhet kompensim. Lartësinë e kompensimit e përcakton këshilli drejtues i institucionit nacional nga paragrafi (1) i këtij neni me akt të përgjithshëm. Lartësia e kompensimit përcaktohet në bazë të kriterëve në vijim: shkallë e dokumentimit paraprak të veprës, përfaqësim të katalogjeve, publikime profesionale dhe shkencore, nevojë për analiza plotësuese të stilit dhe teknikës, nevojë për testime plotësuese laboratorike, analiza kimike dhe analiza të kontekstit të objektit.

(8) Pëlqim të aktit të përgjithshëm nga paragrafi (7) i këtij neni jep ministri.

(9) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni i përcakton ministri."

Neni 10

Kreu VII "KËSHILLI NACIONAL PËR MUZETË", titujt e neneve dhe nenet 34, 35 dhe 36 shlyhen.

Neni 11

Titulli i nenit 39 dhe neni 39 ndryshohen si vijojnë:

"Kushte të veçanta për zgjedhje dhe rizgjedhje në tituj profesional zgjedhorë"

Neni 39

"(1) Në titullin zgjedhor profesional përgjegjës i lartë mund të zgjedhet person i cili ka:

- së paku pesë vite përvojë pune si person përgjegjës ose së paku tre vite përvojë pune si përgjegjës dhe ka mbaruar studimet e magjistraturës, përkatësisht doktoraturës nga sfera përkatëse dhe

- ka dhënë provimin profesional për përgjegjës të lartë.

(2) Në titullin zgjedhor profesional përgjegjës i lartë mund të zgjedhet person i cili ka:

- pesë vite përvojë pune si përgjegjës i lartë dhe

- kontribut profesional në punët nga fusha e veprimtarisë në muze të cilat mund të shprehen me së paku 250 pikë në pajtim me aktin nga neni 42-a të këtij ligji.

(3) Personat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni rizgjidhen në çdo pesë vite.

(4) Në titullin profesional përgjegjës i lartë mund të rizgjidhet person i cili ka dhënë kontribut profesional në punët nga fusha e veprimtarisë në muze nëpërmjet pjesëmarrjes dhe realizimit të projekteve (autorësisë së ekspozitës së muzeut dhe të katalogut, hulumtim profesional, grumbullim dhe përpunim të materialit të muzeut, hulumtime arkeologjike) dhe publikim të punimeve profesionale dhe shkencore dhe publikime nga fusha, që mund të shprehet me së paku 150 pikë në pajtim me aktin nga neni 42-a të këtij ligji.

(5) Në titullin profesional përgjegjës-këshilltar mund të rizgjidhet person i cili ka dhënë kontribut profesional në punët nga fusha e veprimtarisë në muze nëpërmjet pjesëmarrjes dhe realizimit të projekteve (autorësi së ekspozitës së muzeut dhe të katalogut, hulumtim profesional, grumbullim dhe përpunim të materialit të muzeut, hulumtime arkeologjike) dhe publikim të punimeve profesionale dhe shkencore dhe publikime në fushën, që mund të shprehet me së paku 250 pikë në pajtim me aktin nga neni 42-a të këtij ligji.

(6) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, personat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni të cilët kanë edhe dhjetë vite deri në realizimin e të drejtës për pension, nuk i nënshtrohen rizgjidhjes.

(7) Fitimi i titullit profesional është bazë e avancimit të punëtorit profesional në vend më të lartë të punës.”

Neni 12

Para nenit 40 shtohet titull i ri si vijon: “Procedura për dhënie të provimit profesional dhe procedura për zgjedhje”.

Neni 13

Neni 40 ndryshohet si vijon:

“(1) Zgjedhjen dhe rizgjedhjen në titujt zgjedhorë profesionalë nga neni 39 i këtij ligji e bën ministri në bazë të propozimit nga komisioni i recensionit.

(2) Përsecilën sferë lëndë të punës muzeore (arkeologji, histori, etnologji, antropologji, histori e artit, filologji klasike, biologji etj.) emërohen komisione të veçanta të recensionit që përbëhen nga kryetari dhe dy anëtarë që i emëron ministri i Kulturës me mandat prej dy vitesh (në tekstin e mëtejme: Komisioni i Recensionit). Për kryetar dhe anëtarë të komisionit të recensionit emërohen punëtorë shkencorë me titull doktor i shkencave nga sfera përkatëse në të cilën zgjedhet apo rizgjedhet kandidati ose personi me titull profesional kustos këshilltar nga sfera përkatëse në të cilën zgjedhet apo rizgjedhet kandidati. Gjatë emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të komisionit recensues mbahet llogari për parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

(3) Komisioni recensues:

- përcakton nëse personat i plotësojnë kushtet për dhënie të provimit profesional dhe për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional të caktuara me këtë ligj dhe me aktin nga neni 42-a i këtij ligji;

- i vlerëson dhënien e provimit profesional nga neni 39 paragrafi (1) alineja 2 e këtij ligji;

- bën vlerësimin nga neni 39 paragrafi (2) alineja 2 dhe paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji dhe

- i dërgon ministrit propozim për të zgjedhje/ mos zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje/ mos kryerje të rizgjedhjes në titull profesional.

(4) Komisioni recensues, propozimin nga paragrafi (3) alineja 4 të këtij neni ia dërgon ministrit në afat prej 30 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional.

(5) Propozimi nga paragrafi (3) alineja 4 të këtij neni përmban: të dhëna biografike për kandidatin, vlerësim të plotësimit të kushteve për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesional, vlerësim për zgjedhje në titull profesional sipas rezultateve nga provimi profesional dhe vlerësim për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titull profesionale në përputhje me pikët e fituara nga akti i nenit 42-a të këtij ligji.

(6) Procedura për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional zgjat më së shumti dy muaj.

(7) Ministri në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit nga komisioni recensues miraton aktvendim për zgjedhje/ mos kryerje të zgjedhjes, përkatësisht të rizgjedhje/ moskryerje të rizgjedhjes në titull profesional.

(8) Kundër aktvendimit nga paragrafi (7) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve në Komisionin Shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë. Ankesa nuk e prolongon zbatimin.

(9) Punët administrativo-teknike për komisionin e recensionit i kryen Ministria.”

Neni 14

Titulli i nenit 41 dhe neni 41 ndryshohen si vijon:

“Nisja e procedurës për zgjedhje dhe rizgjedhje në titull profesional

Neni 41

(1) Procedura për zgjedhje në titull profesional niset me kërkesë të punëtorit të interesuar profesional.

(2) Nëse punëtori profesional nuk zgjedhet në titullin profesional për shkak të mosplotësimit të kushteve në titull profesional, ka të drejtë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të aktvendimit për të mos kryerje të zgjedhjes në titull profesional të parashtojë kërkesë të re për zgjedhje në titull profesional.

(3) Procedurën për rizgjedhje në titull profesional e nis drejtori i muzeut publik, më së voni në afat prej tre muajsh para kalimit të afatit për rizgjedhje.

(4) Nëse punëtori profesional nuk rizgjedhet në titullin profesional për shkak të mosplotësimit të kushteve për rizgjedhje në titullin profesional të caktuara me këtë ligj, ka të drejtë në afat prej gjashtë muajsh të rizgjedhjes, ndërsa vazhdon me punë në vendin e njëjtë të punës me titullin e njëjtë profesional.

(5) Nëse edhe për herë të dytë nuk rizgjedhet, punëtori profesional humb titullin profesional paraprakisht të fituar dhe në afat prej 30 ditëve me aktvendim të drejtorit sistematizohet në vend tjetër të punës në titull më të ulët profesional nga titulli profesional i fituar paraprakisht. Punëtori profesional, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e shpërndarjes në vend tjetër pune në titull më të ulët profesional, ka të drejtë të parashtojë kërkesë të re për zgjedhje në titull më të lartë profesional nga ai ekzistues, në procedurë në pajtim me këtë ligj.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, punëtori profesional në afat prej 15 ditësh nga dita e fitimit të aktvendimit ka të drejtë kundërshtimi te këshilli drejtues i muzeut publik. Këshilli drejtues vendos për kundërshtimin në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të kundërshtimit.

(7) Kundër vendimit të këshillit drejtues në afat prej 30 ditëve nga dita e miratimit të vendimit të këshillit drejtues, mund të parashtrohet padi në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon zbatimin.”

Neni 15

Neni 42 ndryshohet si vijon:

“Punët profesionale në muze i kryejnë punëtorë me tituj profesionale jozgjedhorë të cilët kanë arsimin përkatës të mesëm për titullin preparues, arsim sipëror përkatës ose së paku 180 kredi SETK të marra për titullin preparues i pavarur dhe arsim të lartë përkatës, respektivisht 240 kredi të marra sipas SETK për titujt kustos, udhërrëfyes muzeor dhe edukator muzeor.”

Neni 16

Pas nenit 42 shtohet nen i ri 42-a, si vijon:

“Neni 42-a

Ministri i përcakton përkatësinë e llojit të arsimit dhe përshkrimin e titujve profesionalë në fushën e veprimtarisë së muzeut, programin për dhënie të provimit profesional dhe mënyrën e përcaktimit të pikëve për zgjedhje, përkatësisht rizgjedhje në titujt profesionalë.”

Neni 17

Në nenin 45-a paragrafi (1) pas alinesë 1 shtohen tri aline të reja 2, 3 dhe 4, si vijojnë:

“- nuk kryen kontrollim paraprak të prejardhjes së materialit të muzeut dhe objekteve të muzeut (neni 18 paragrafi (2));

- nuk siguron dëshmi për pronësinë e materialit të muzeut dhe objekteve të muzeut dhe nuk siguron deklarata të verifikuar në noter (neni 18 paragrafi (3));

- nuk zbaton masa të mbrojtjes preventive dhe permanente për materialin e muzeut dhe objektet e muzeut (neni 19);”.

Pas alinesë 2, që bëhet alineja 5, shtohet aline e re 6, si vijon:

“-nuk parashtrojnë tre ekzemplare identikë të secilës bankënotë dhe monedhë (neni 22-a paragrafi (1))”.

Në alinenë 5, që bëhet alineja 9, pas fjalës “përpunon” shtohen fjalët: “dhe shet”, kurse pika në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Pas alinesë 5, që bëhet alineja 9, shtohen tri aline të reja 10, 11 dhe 12 si vijojnë:

“-miraton aktvendim për themelimin të komisionit për vlerësim profesional të origjinalitetit të objekteve artistike dhe të tjera, pa pëlqim nga ministri i kulturës (neni 29-a paragrafi (2));

- nuk e jep mendimin për vlerësim profesional të origjinalitetit të objekteve artistike dhe të tjera në afatin e caktuar (neni 29-a paragrafi (3));

- nuk nis procedurë për rizgjedhje në titullin profesional në afatin e caktuar (neni 41 paragrafi (3)).

Në paragrafin (3) fjalët “alineja 5” zëvendësohen me fjalët “alineja 9”.

Në paragrafin (4) fjalët “alinetë 3, 4 dhe 5” zëvendësohen me fjalët “alinetë 7, 8 dhe 9”.

Në paragrafin (5) fjalët “alineja 5” zëvendësohen me fjalët “alineja 9”.

Neni 18

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 19

(1) Personave të cilët deri në ditën e fillimit të zbatimit të dispozitave nga nenet 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të këtij ligji kanë marrë titull profesional në pajtim me Ligjin për muzetë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/2004, 89/2008, 116/10 dhe 51/11) titulli i marrë u pranohet në pajtim me këtë ligj.

(2) Procedurat për marrjen e titujve profesionalë të filluara sipas dispozitave të cilat kanë qenë në fuqi para fillimit të zbatimit të dispozitave të neneve 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të këtij ligji, do të përfundohen sipas Ligjit për muzetë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/2004, 89/2008, 116/10 dhe 51/11).

Neni 20

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për ekzemplarin e detyrueshëm (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 11/1994, 92/2008 dhe 47/11).

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa dispozitat e neneve 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2016.